

**PLATFORMA PER QEVERISJEN DEMOKRATIKE
NE BOTEN ISLAMIKE
STAMBOLL, TURQI
14 PRILL 2004**

Ne, në rolin tonë si praktikues politikë nga vende me shumicë muslimane në Afrikë, Azi, Europë dhe Lindje të Mesme u mblodhëm në Stamboll, Turqi, nga data 12 deri 14 Prill 2004 në Kongresin e Demokratëve nga Bota Islame. Ne jemi ish kryetarë dhe kryetarë të tanishëm të shteteve dhe qeverive, ministra kabinetesh qeveritarë, anëtarë parlamentesh dhe lidera politikë dhe qytetarë me eksperiencë në qeverisjen dhe pjesëmarrjen demokratike. Duke reflektuar shpresat dhe aspiratat e popujve tanë, ne jemi të vendosur të ofrojmë platformën e mëposhtme për Qeverisjen Demokratike në Botën Islame.

HYRJE

Parimet e kulturës Islamike përfshijnë tolerancën, drejtësinë dhe pjesëmarrjen. Këto parime sigurojnë themelet për qeverisje demokratike në të gjithë botën. Këto parime, me zbatimin e tyre provojnë se shprehjet kulturore dhe proceset demokratike mbështesin njera tjetrën. Duke iu përmbajtur këtyre parimeve dhe nepërmjet experiencës dhe sukseseve tona, ne konfirmojmë përputhshmërinë e Islamit dhe demokracisë.

Këto parime të kulturës Islame kërkojnë një proces politik demokratik që ruan identitetin tonë të përbashkët kulturor ndërkohe që iu garanton të gjithë individëve të drejtat dhe liritë e tyre siç renditen në Kartën e Kombeve të Bashkuara (OKB), të Bashkimit Europian (BE), në deklaratën e Varshavës, në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, në Kartën Europiane të të Drejtave Themelore, Konventën e OKB mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Partnership i Ri për Zhvillimin e Afrikës, Deklaratën për Demokraci, Qeverisja Politike, ekonomike dhe kolegjiale, dhe Deklaratat e Sanës të vitit 1999 dhe 2004.

Secili nga këto parime mbart me vete angazhime ndaj të cilave janë përkushtuar të gjithë demokratët e botës Islamike.

Në lidhje me principet dhe vlerat e mësipërme, të bindur se egzistenca e pikpamjeve të ndryshme më tepër forcon sesa dobëson shoqëritë tona, ne besojmë si më poshtë:

TOLERANCË

- § Liria e mendimit, ndërgjëgjjes dhe e besimit fetar;
- § E drejta për të mbrojtur dhe shprehur mendimet;
- § Liria dhe pluralizmi i medias; dhe
- § E drejta për grumbullime paqësore dhe liria për tu shoqëruar me të tjerët.

DREJTËSI

- Të drejta të barabarta për të gjithë njerëzit, pa dallime të asnjë lloji të tillë si raca, ngjyra, seksi, gjuha, besimi fetar, politik apo mendimi tjetër, origjina kombëtare apo sociale, pasuria, lindja apo status tjetër social;
- Parimi i barazisë nuk do të ndalojë mbajtjen apo adaptimin e masave që sigurojnë avantazhe të veçanta në favor të atyre grupeve që deri tani kanë qënë të nën-përfaqësuar në procesin tonë politik duke përfshirë gratë;
- Sundimi i ligjit dhe një sistem gjyqësor i pavarur;
- Liria nga torturat, persekutimi dhe ndëshkimi mizor ose i pazakontë;
- Reduktimi i varfërisë dhe nxitja e zhvillimit.

PJESMARRJE

- Zgjedhje të lira, të drejta të rregullta shumëpartiake që rrisin besimin e publikut nëpërmjet krijimit të komisioneve zgjedhore të pavarura, jopartizane ose të ekuilibruara politikisht dhe që u sigurojnë të drejtën e votës të gjithë qytetarëve që kanë mbushur moshën për të votuar, pavarësisht nga gjinia
- Procese demokratike vendim-marrëse që inkurajojnë pjesëmarrjen publike
- Shoqëri që janë të informuara dhe të hapura nëpërmjet burimeve të medias së pavarur, programeve të edukimit civil dhe të një shoqërie e civile aktive
- Parti politike dhe legjislative që legjitimohen nëpërmjet qeverisjes transparente dhe demokratike
- Një sistem qeverisje demokratike që synon të parandalojë korrupsionin dhe të forcojë sundimin e ligjit nëpërmjet mekanizmeve të transparencës, lirisë së informimit dhe mbikqyrjes së pavarur qytetare
- Masa efektive që e bëjnë arsimimin të disponueshëm dhe të arritshëm për të gjithë
- Politika financiare transparente dhe qeverisje kolegjiale që kontribuojnë në begatinë ekonomike

Platforma tregon se parimet e Islamit dhe parimet e qeverisjes demokratike janë me të vërtetë të pajtueshme.

Ne besojmë se të gjithë kombet dhe individët që ndjekin parimet e kësaj platforme do të kontribuojnë në dinjitetin njerëzor, bashkimin social, prosperitetin ekonomik dhe sigurinë duke nxitur mirëkuptimin dhe paqen mes gjithë popujve.

Ne zotohemi ti japim shprehje konkrete të gjithë këtyre parimeve përmes iniciativave pasuese dhe një rrjeti demokratësh prej botës Islamike.